# SI TË APLIKOSH PËR KONFIRMIMIN E AKT-KONTROLLEVE

## SIPAS FAZAVE TË NDËRTIMIT

UDHËZUES PËR PROFESIONISTËT DHE QYTETARËT

BASHKIA
TIRANË

**Udhëzuesi për profesionistët dhe qytetarët:**
***"Si të aplikosh për konfirmimin e akteve të kontrollit sipas fazave të ndërtimit"***

**AUTOR**
Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit,
Bashkia Tiranë.

**UDHËHEQËS TË PROCESIT:**
**Ditjon Baboçi,** Drejtor i Përgjithshëm
*Drejtoria e përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit*
**Frida Pashako**, Drejtor
Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit

**DREJTUES I GRUPIT TË PUNËS:**
**Dition Shkurtaj,** Përgjegjes Sektori
*Sektori i Kontrollit të Zbatimit të Lejeve*

**GRUPI I PUNËS:**
**Specialistë:**
*Sektori i Kontrollit të Zbatimit të Lejeve:*
Arziko Bardhi, Izabela Martini, Eglantina Qerama, Enkelejda Gubera, Sirius Strepi, Ermira Frangu, Agisa Xhemalaj, Donald Lutaj, Ermal Grabova, Mirgen Beqka.

**REALIZIMI GRAFIK:**
Iva Tavanxhiu

Tiranë, 2018



## SHËNIM I RËNDËSISHËM

Roli i këtij udhëzuesi është orientues për mënyrën e aplikimit për konfirmimin e akt-kontrolleve sipas fazave të ndërtimit, dhe do të jetë vazhdimisht në proces përditësimi në varësi të ndryshimit të legjislacionit, rregulloreve në zbatim të ligjeve përkatëse në fuqi, urdhëresave të ndryshme apo koncepteve që kanë nevojë të spjegohen.

Sugjerimet e dhëna në këtë udhëzues nuk janë shteruese, pasi vetë rastet e aplikimit për konfirmim kontrollesh si dhe problematikat e objekteve gjatë zbatimit të tyre janë nga më të ndryshmet dhe trajtimet e tyre nuk janë standarte.

Referencat ligjore të cituara në këtë udhëzues i përkasin kohës së përgatitjes së tij, prandaj çdo përdorues i këtij udhëzuesi duhet të jetë i kujdesshëm t'i referohet bazës ligjore të përditësuar nga burimet zyrtare në momentin e përdorimit të tij.

# TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE 6

HAPI 1 - Aplikimi i akt-kontrollit “Ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues” 13

HAPI 2 - Aplikimi i akt-kontrollit “Piketimi i strukturës” 21

HAPI 3 - Aplikimi i akt-kontrolli “Përfundimi i themeleve dhe kuota ±0.00M” 29

HAPI 4 - Aplikimi i akt-kontrollit “Përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin” 37

HAPI 5 - Aplikmi i akt-kontrollit “Përfundimi i fasadave dhe rifiniturave, ushtrohet vetëm pasi të ketë përfunduar procedura e depozitimit dhe konfirmimit të karabinasë”. 45

HAPI 6 - Aplikimi i akt-kontrolli “Përfundimi i sistemimit të jashtëm, në planin e vendosjes së strukturës së re, përfshirë vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturat publike ekzistuese” 53

Permbledhja e procesit të aplikimit për konfirmimin e akt-kontrolleve 67

# HYRJE

Udhëzuesi për profesionistët dhe qytetarët u përgatit nga Bashkia e Tiranës me mbështetje teknike të Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

**QËLLIMI I UDHËZUESIT**

Udhëzuesi ***"Si të aplikosh për konfirmimin e akt-kontrolleve, sipas fazave të ndërtimit"*** i vjen në ndihmë profesionistëve të fushës si arkitektë, Inxhinier, topografë, dhe të interesuarve që aplikojnë për kryerjen apo konfirmimin e kontrolleve sipas fazave të ndërtimit duke i udhëzuar për bazën ligjore, dokumentacionin e nevojshëm për pajisjen me leje, autoritetet të cilët kanë të drejta vendimarrje, afatet e kërkuara, etj.

**MENYRA TË TJERA INFORMIMI PËRVEÇ KËTIJ UDHËZUESI**

Për çdo pyetje apo informimim mbi mënyrën e aplikimit për kryerjen apo konfirmimin e kontrolleve sipas fazave të ndërtimit mund të interesoheni pranë:

- Zyrave të Komunikimit me Qytetarët pranë Bashkisë së Tiranës
- Portalit zyrtar të Bashkisë së Tiranës:

*www.tirana.al*



# UDHËZUES TË TJERË APLIKIMI PER LEJE

Ky udhëzues është pjesë e një pakete informative për zbatimin e bazës tekniko - ligjore sipas kushteve të zhvillimit të përcaktuara në legjislacionin dhe rregulloret përkatëse në fuqi, së bashku me *Udhëzuesin "Si të aplikosh për Leje Zhvillimi", Udhëzuesin "Si të aplikosh për Leje Ndërtimi", Udhëzuesin "Si të aplikosh për çertifikatë përdorimi", Udhëzuesin "Si të aplikosh për Plan të Detajuar Vendor", Udhëzuesin "Si të aplikosh për Deklaratë Paraprake për Kryerje Punimesh" dhe Udhëzuesin "Si të aplikosh për Gen-plan Azhornimi".*


















# AKRONIME

| | |
|---|---|
| **SKZL** | – Sektori i Kontrollit të Zbatimit të Lejeve |
| **DPPZHT** | – Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit |
| **DKZHT** | – Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit |
| **ZVRPP** | – Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme |
| **IMT** | – Instituti i Mbrojtjes së Territorit |



# ÇFARË ËSHTË KRYERJA / KONFIRMIMI I KONTROLLEVE SIPAS FAZAVE TË NDËRTIMIT?

Kontrolli dhe verifikimi i fazave të ndërtimit siguron një proces të rregullt ndërtimor duke arritur trajtimin e një problematike apo shkelje të kushteve të lejes së lejes së ndërtimit që në fillesat e veta, pa lejuar vazhdimin e ndërtimit me shkelje dhe duke mbrotjur interesat e ligjshme të pronarëve të truallit, investitorit, kufitarëve apo personave të tretë.

Paralelisht me kontrollin teknik që kryen *Sektori i Kontrollit të Zbatimit të Lejeve*, struktura kryesore e cila monitoron në çdo kohë gjithë procesin e ndërtimit, është *Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit* pranë Bashkisë Tiranë.

Monitorimi i ndërtimit nga ana e kësaj strukture shkon në harmoni me aktet teknike të kontrollit, pasi në çdo fazë, subjektit i kërkohet konfirmimi nga *Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.*

# NË ÇFARË RASTI APLIKOJMË PËR KONFIRMIMIN E AKT-KONTROLLEVE SIPAS FAZAVE TË NDËRTIMIT?

**PAS MIRATIMIT TË LEJES SË NDËRTIMIT DHE FILLIMIN E PUNIMEVE**, subjektet ndërtuese nëpërmjet subjekteve të liçensuar në fushën e mbikqyrjes, kanë detyrimin që për çdo fazë ndërtimi, hap pas hapi, të hartojnë akt-kontrollet teknike të fazave të ndërtimit dhe të njoftojnë Bashkinë e Tiranës / DPPZHT, për kontrollin dhe verifikimin e realizimit të tyre.

Akt-kontrollet teknike të fazave të ndërtimit janë 6, përkatësisht:

01_ *Akt - Kontrolli **"Ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues"***
02_ *Akt - Kontrolli **"Piketimi i strukturës"***
03_ *Akt - Kontrolli **"Përfundimi i themeleve dhe kuota ± 0.00m"***
04_ *Akt - Kontrolli **"Përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin"***
05_ *Akt - Kontrolli **"Përfundimi i fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re, përfshirë instalimet elektrike, të ngrohjes, ftohjes, hidraulike, të komunikimit elektronik"***
06_ *Akt - Kontrolli **"Përfundimi i sistemimit të jashtëm, në planin e vendosjes së strukturës së re,përfshirë vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturat publike ekzistuese"***

*SKZL ushtron kontroll referuar akteve të depozituara dhe konfirmon ose jo kryerjen e punimeve sipas fazave të grafikut të punimeve dhe afatit të lejes per pikat "01", "03", "04", "06".*



# MËNYRA E APLIKIMIT

Aplikimi për konfirmimin e akt-kontrolleve sipas fazave te ndërtimit kryhet **VETËM** pranë ***Sportelit të Pritjes me Qytetarët pranë Bashkisë së Tiranës.***

# 01 APLIKIMI I AKT-KONTROLLIT **“NGRITJA E KANTIERIT TË PUNIMEVE, PËRFSHIRË MURIN RRETHUES”**

*Akt-kontrollit “**Ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues**”, ushtrohet vetem pasi në sheshin për të cilin është miratuar leja e ndërtimit të kenë përfunduar punimet e rrethimit provizor të kantierit, prishja e objekteve ekzistues për çdo rast sipas vendimit të kryetari të Bashkisë për lejen e ndërtimit, të jetë kryer vendosja e tabelës informuese, hyrja në kantier, ngritja e zyrave të kantierit, ËC dhe vend depozitimi i materialeve sipas plan organizimit të punimeve të miratuar në lejen e ndërtimit.*

# 1/1 HARTIMI I AKT - KONTROLLIT

Ushtrimi dhe hartimi i *Akt - Kontrollit* ***"Ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues"*** kryhet nga:

**1/ Drejtuesi teknik i subjektit ndërtues**
**2/ Topograf i objektit liçensuar në zbatim ose mbikqyrje**
**3/ Mbikqyrësi i objektit**

Plotësimi i akt-kontrollit do të kryhet sipas formatit të ilustruar në faqen pasardhëse miratuar nga Bashkia e Tiranës, i cili mund të gjendet pranë *Sportelit të Pritjes me Qytetarët* pranë Bashkisë së Tiranës ose pranë *SKZL-së.*



ANEKSI 2-9 / A

**AKT- KONTROLL**
(Kantieri i Punimeve)

Mbështetur në ligjin nr. 8402, datë 10/09/1998, për "Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" (i ndryshuar), neni 27/1 VKM nr. 408 datë 13.05.2015 (i ndryshuar), u ushtrua kontroll për ngritjen e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues, në sheshin ku do të realizohet ndërtimi, për objektin "……………………………………………………………………", miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë me **nr.** ………… , **datë** ……………, leje ndërtimi me **nr.prot.** ……………………, datë ……………………, me adresë në rrugën **"**………………………………**"** në pronë të ………………………………, në favor të zhvilluesit **"**…………………**"** dhe subjektit ndërtues shoqërisë **"**…………………**" *shpk***

Nga kontrolli i ushtruar rezulton se:

1. **Rrethimi i sheshit të ndërtimit:** Është realizuar/ Nuk është realizuar.
2. **Vendosja e tabelës informuese:** Është realizuar/ Nuk është realizuar.
3. **Lirimi i sheshit nga ndërtimet ekzistuese:** Është realizuar/ Nuk është realizuar.
4. **Hyrja në kantjer:** Është realizuar/ Nuk është realizuar.
5. **Vendi i depozitimit të materialeve:** Është realizuar/ Nuk është realizuar.
6. **Zyra e kantierit:** Është realizuar/ Nuk është realizuar.

Shenim: (Për çdo pikë, në rastin kur projekti eshte zbatuar me ndryshime, te detajohet ndryshimi)

INXHINIER TOPOGRAF ____________________

DREJTUESI TEKNIK ____________________

MBIKËQYRËSI I PUNIMEVE ____________________

**SHËNIM**

*Formatin e Akt-Kontrollit "Ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues" mund ta shkarkoni në faqen zyrtare të Bashkisë së Tiranës:*

*www.tirana.al*

***> Udhëzuesi "Si të aplikosh për konfirmimin e akt-kontrolleve, sipas fazave të ndërtimit"***

*> Aneksi 2-9 / A*

## 1/2 APLIKIMI PËR AKT-KONTROLL

Aplikimi për konfirmimin e *Akt-kontrollit* ***"Ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues"*** kryhet pranë *Sportelit të Pritjes me Qytetarët* pranë Bashkisë së Tiranës.

Aplikuesi mund të jetë:
**- Subjekti ndërtues**
**- Zhvilluesi**
**- Çdo person i pajisur me prokurë apo autorizim nga subjekti ndërtues apo zhvillues**

## DOKUMENTET PËR APLIKIM

Dokumentacioni i kërkuar i cili duhet depozituar pranë DPPZHT, përmban:

☐ 1/ **Kërkesë shkresore sqaruese për ushtrimin e kontrollit**, me të dhënat identifikuese të objektit sipas lejes së ndërtimit si dhe subjektit që ka ushtruar kontrollin.

☐ 2/ **Akt-kontrolli** i hartuar dhe nenshkruar nga subjekti privat i licensuar. Akti i kontrollit plotesohet sipas Formatit të Aneksit 2-9/A.

☐ 3/ **Deklaratë noteriale përgjegjësie e subjektit** që ka ushtruar dhe hartuar akt-kontrollin. Në deklaratën e përgjegjësise duhet të përfshihet topografi I liçensuar, drejtuesi teknik i subjektit ndërtues dhe mbikqyrësi, të cilët duhet të shprehen mbi vërtetesinë e akt kontrollit të ushtruar prej tyre si dhe zbatimin ose jo të objektit deri në fazën aktuale referuar projektit të miratuar.

***SHËNIM***

*Shih faqen 15.*
*Aneksi 2-9/A: Akt-Kontrolli "Ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues"*

☐ 4/ **Kopje e noterizuar e liçencës së subjektit** që ka ushtruar kontrollin e mëposhtëm:

☐ • Liçensa e subjektit ndërtues
☐ • Liçensa individuale/shoqerise për punimet topogjeodezike në zbatim ose mbikqyrje
☐ • Liçensa e mbikqyrësit të punimeve

☐ 5/ **Foto të gjendjes faktike** ku pasqyrohet realizimi i punimeve sipas pikave të përcaktuara në akt-kontroll.
Fotot janë dokumentacion plotësues i cili shoqëron akt-kontrollin dhe vërteton përfundimin e punimeve të përcaktuara në akt kontroll.

***SHËNIM***

*Për lejet e miratuara nga ish-Komunat, paraprakisht, subjektet ose DKZHT, i drejtohen Njësive Administrative përkatëse që këto të fundit të dërgojnë kopje të njehsuar të dokumentacionit të lejes së ndërtimit, planvendosjen e miratuar, projektin e miratuar, akt-kontrolle nëse ka etj., pranë DPPZHT.*
*Në çdo rast, së bashku me dokumentacionin e Njësisë Administrative duhet të depozitohen edhe dokumentat sipas pikave të sipërcituara.*

# 1/3 KONFIRMIMI I AKT-KONTROLLIT




## APLIKIMI PËR KONFIRMIMIN E AKT-KONTROLLIT “NGRITJA E KANTIERIT TË PUNIMEVE, PËRFSHIRË MURIN RRETHUES”

Aplikimi për konfirmimin e Akt-kontrollit kryhet pranë Sportelit të Pritjes me Qytetarët pranë Bashkisë së Tiranës.

Kërkesa për konfirmimin e akt-kontrollit së bashku me dokumentacionin përkatës delegohet në strukturën përkatëse *“Sektori i Kontrollit të Zbatimit të Lejeve (SKZL)”* nëpërmjet të cilës specialistët inxhinier / arkitekt / topograf vijojnë me verifikimin e objektit.




## VLERËSIMI I APLIKIMIT TË AKT-KONTROLLIT NGA SKZL

Brenda 15 ditë pune, SKZL kthen përgjigje për aplikacionin duke vlerësuar aplikimin në lidhje me dokumentacionin përkatës dhe kontrolluar gjendjen faktike të objektit

### 2/1 KONFIRMIMI I AKT-KONTROLLIT

Nëse aplikimi për konfirmimin e Akt- kontrollit *“Ngritja e Kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues”*, është në rregull me dokumentacionin dhe kontrollin e gjendjes faktike në terren, jepet konfirmimi nga SKZL për të vazhduar me Akt-kontrollin *“Piketimi i strukturës”*.

### 2/2 NJOFTIM PËR PLOTËSIM / SAKTËSIM DOKUMENTACIONI

- Njoftimi për plotësim dokumentacioni nëse aplikimi ka mungesa apo nevojë për saktësim.
- Plotësimi i dokumentacionit nga aplikuesi.
- Pas plotësimit të dokumentacionit, kontrollohet gjendja faktike e objektit në terren.
- Konfirmimi i akt-kontrollit pas plotësimit të saktë të dokumentacionit.

### 2/3 KONSTATIM MOSPËRPUTHSHMËRIE

Në rast se konstatohen shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit SKZL njofton IMT.




## VLERËSIMI I AKT - KONTROLLIT NGA IMT

Inspektoriatit Vendor i Mbrojtjes së Territorit merr njoftimin dhe vazhdon me procedurën përkatëse.

# 02 APLIKIMI I AKT-KONTROLLIT **"PIKETIMI I SRUKTURËS"**

*Akt-kontrolli "Piketimi i strukturës", ushtrohet vetem pasi të kete përfunduar procedura e konfirmimit të kontrollit të kantierit sipas përcaktimeve në Hapin 01 (fq.13). Piketimi i strukturës kryhet para procesit të gërmimit. Nëpërmjet këtij kontrolli kryhet piketimi, verifikimi në vend dhe përcaktimi i vendosjes së strukturës sipas kondicioneve urbane të përcaktuara në planvendosjen e miratuar.*

# 2/1 HARTIMI I AKT-KONTROLLIT

Ushtrimi dhe hartimi i *Akt-kontrollit* ***"Piketimi i Strukturës"*** kryhet nga:

**1/ Drejtuesi teknik i subjektit ndërtues**
**2/ Topograf i objektit liçensuar në zbatim ose mbikqyrje**
**3/ Mbikqyrësi i objektit**

Plotësimi i akt kontrollit do të kryhet sipas formatit të ilustruar në faqen pasardhëse miratuar nga Bashkia e Tiranës, i cili mund të gjendet pranë *Sportelit të Pritjes me Qytetarët* pranë Bashkisë së Tiranës ose pranë *SKZL-së.*



**ANEKSI 2-9 / B**

***AKT- KONTROLL***
(Për piketimin e objektit)

Mbështetur në ligjin nr. 8402, datë 10/09/1998, për "Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit (i ndryshuar), neni 27/1 VKM nr. 408 datë 13.05.2015 (i ndryshuar), u ushtrua kontroll për piketimin në sheshin ku do të realizohet ndërtimi për objektin "..........................................................................", miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë me **nr.** ............ , **datë** ................, leje ndërtimi me nr.prot. .........................., datë .........................., me adresë në rrugën "...................................." në pronë të ...................................., në favor të zhvilluesit " ..................." dhe subjektit ndërtues shoqërisë " ......................" *shpk.*

Bashkëngjitur dhe Akt-kontroll spostimi i rrjetit inxhinierik i ujësjellës - kanalizimeve.

**1.Veri:** Piketuar ballë i (drejtë/shkallëzuar) me gjatësi ......m në distancë ......m nga (kufiri i pronës/ mur rrethues/objekt ekzistues), miratuar ballë i (drejtë/shkallëzuar) me gjatësi ......m në distancë ......m nga (kufiri i pronës/ mur rrethues/objekt ekzistues).
(..............................................................................................................................)

**2.Lindje:** Piketuar ballë i (drejtë/shkallëzuar) me gjatësi ......m në distancë ......m nga (kufiri i pronës/ mur rrethues/objekt ekzistues), miratuar ballë i (drejtë/shkallëzuar) me gjatësi ......m në distancë ......m nga (kufiri i pronës/ mur rrethues/objekt ekzistues).
(..............................................................................................................................)

**3.Perëndim:** Piketuar ballë i (drejtë/shkallëzuar) me gjatësi ......m në distancë ......m nga (kufiri i pronës/ mur rrethues/objekt ekzistues), miratuar ballë i (drejtë/shkallëzuar) me gjatësi ......m në distancë ......m nga (kufiri i pronës/ mur rrethues/objekt ekzistues).
(..............................................................................................................................)

**4.Jug:** Piketuar ballë i (drejtë/shkallëzuar) me gjatësi ......m në distancë ......m nga (kufiri i pronës/ mur rrethues/objekt ekzistues), miratuar ballë i (drejtë/shkallëzuar) me gjatësi ......m në distancë ......m nga (kufiri i pronës/ mur rrethues/objekt ekzistues).
(..............................................................................................................................)

Shenim: (Për çdo pikë, në rastin kur projekti eshte zbatuar me ndryshime, te detajohet ndryshimi)

**INXHINIER TOPOGRAF** ______________________

**DREJTUESI TEKNIK** ______________________

**MBIKËQYRËSI I PUNIMEVE** ______________________

**SHËNIM**

*Formatin e Akt-Kontrollit "Piketimi i objektit" mund ta shkarkoni në faqen zyrtare të Bashkisë së Tiranës:*

*www.tirana.al*

***> Udhëzuesi "Si të aplikosh për konfirmimin e akt-kontrolleve, sipas fazave të ndërtimit"***

*> Aneksi 2-9 / B*

## 2/2 APLIKIMI PËR AKT-KONTROLL

Aplikimi për konfirmimin e kontrollit "Piketimin e Strukturës", kryhet pranë *Sportelit të Pritjes me Qytetarët* pranë Bashkisë së Tiranës.

Aplikuesi mund të jetë:
**- Subjekti ndërtues**
**- Zhvilluesi**
**- Çdo person i pajisur me prokurë apo autorizim nga subjekti ndërtues apo zhvillues**

## DOKUMENTET PËR APLIKIM

Dokumentacioni i kërkuar i cili duhet depozituar pranë DPPZHT, përmban:

☐ 1/ **Kërkesë shkresore për depozitim e kontrollit**, me të dhënat identifikuese të objektit sipas lejes së ndërtimit si dhe subjektit që ka ushtruar kontrollin.

☐ 2/ **Akt-kontrolli** i hartuar dhe nenshkruar nga subjekti privat i licensuar. Akti i kontrollit plotesohet sipas Formatit të Aneksit 2-9/B.

☐ 3/ **Deklaratë noteriale përgjegjësie e subjektit** që ka ushtruar dhe hartuar akt-kontrollin. Në deklaratën e përgjegjësise duhet të përfshihet topografi I liçensuar, drejtuesi teknik i subjektit ndërtues dhe mbikqyrësi, të cilët duhet të shprehen mbi vërtetesinë e akt kontrollit të ushtruar prej tyre si dhe zbatimin ose jo të objektit deri në fazën aktuale referuar projektit të miratuar.

*SHËNIM*

*Shih faqen 23.*
*Aneksi 2-9/B*
*Akt Kontrolli "Piketimi i Strukturës"*

☐ 4/ **Kopje e noterizuar e liçencës së subjektit** që ka ushtruar kontrollin e mëposhtëm:

☐ • Liçensa e subjektit ndërtues
☐ • Liçensa individuale / shoqerise për punimet topogjeodezike në zbatim ose mbikqyrje
☐ • Liçensa e mbikqyrësit të punimeve

☐ 5/ **Kopje e aktit të kontrollit të mëparshëm:**
01_ Akt - Kontrolli *"Ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues"*

☐ 6/ **Foto të gjendjes faktike** ku pasqyrohet realizimi i punimeve sipas pikave të përcaktuara në akt-kontroll.
Fotot janë dokumentacion plotësues i cili shoqëron akt-kontrollin dhe vërteton përfundimin e punimeve të përcaktuara në akt kontroll.

*SHËNIM*

*Shih Akt-Kontrollin "Ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues", faqe 13.*

*SHËNIM*

*Për lejet e miratuara nga ish-Komunat nëse projekti nuk është depozituar më parë pranë DPPZHT-së, paraprakisht subjektet ose DKZHT i drejtohen Njësive Administrative përkatëse që këto të fundit të dërgojnë kopje të njehsuar të dokumentacionit të lejes së ndërtimit, planvendosjen e miratuar, projektin e miratuar, akt-kontrolle nëse ka etj., pranë DPPZHT.*
*Në çdo rast, sëbashku me dokumentacionin e Njësisë Administrative duhet të depozitohen edhe dokumentat sipas pikave të sipërcituara.*

☐ **7/** Dy kopje origjinale të **Akt-kontrollit "Spostimi i infrastrukturës ekzistuese"**, lëshuar nga UKT-ja.



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri
Tel: 00 355 42240978
info@ukt.al
NIPT J62005002O

**MIRATOI**

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**AKT – KONTROLL SPOSTIMI**

**I RRJETIT INXHINIERIK TË UJËSJELLËS – KANALIZIME**

Subjekti ndërtues: **sh.p.k.** me shkresë Nr. Prot. datë ka paraqitur kërkesën për akt kontroll spostimi të rrjetit inxhinierik pranë U.K.T. sh.a. të objektit: në pronë të me adresë: Tiranë, për të cilën ka marrë leje ndërtimi nga Bashkia Tiranë, me Vendim Nr. datë

**Nga kontrolli i ushtruar rezulton se :**

**RRJETI I UJËSJELLËSIT:**

Subjekti ndërtues: **sh.p.k.** ka kryer zbatimin e punimeve të rrjetit të ujësjellësit sipas projektit. **Nuk ka rrjet ujësjellësi që administrohet nga shoqëria UKT sh.a. për të spostuar.**

Cilësia e punimeve të zbatimit është _____.

**RRJETI I KANALIZIMIT:**

Subjekti ndërtues: **sh.p.k.** ka kryer zbatimin e punimeve të rrjetit të K.U.Z sipas projektit **Nuk ka rrjet kanalizimi që administrohet nga shoqëria UKT sh.a. për të spostuar.**

Cilësia e punimeve të zbatimit është ______.

**Akt-Kontroll Spostimi mbahet ne 5 kopje, nga të cilat 2 kopje i bashkangjiten dokumentacionit teknik i arkivës së degëve përkatëse, 2 kopje dorëzohen në Urbanistikë pranë Bashkisë, 1 kopje për subjektin ndërtues.**

**Drejtor Departamenti Inxhinierik**

**Ing. O**

Ujësjellës Kanalizime sh.a. Tiranë NIPT J62005002O Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri,
Tel: 00 355 42240978,info@ukt.al.



# 2/3 KONFIRMIMI I AKT-KONTROLLIT

***SHËNIM***

*Për Akt-kontrollin **"Piketimi i strukturës"** nuk kryhet konfirmim dhe kontroll nga DKZHT. Kontrolli depozitohet dhe arkivohet në arkivën teknike së bashku me dokumentacionin shoqërues.*

*Në rastet kur kontrolli i depozituar reflekton gabime ose dokumentacioni nuk është i plotë, DKZHT njofton subjektin ndërtues mbi plotësimet apo korrigjimet përkatëse.*

# 03 APLIKIMI I AKT-KONTROLLIT
# “PËRFUNDIMI I THEMELEVE DHE KUOTA ± 0.00m”

*Akt-kontrolli “Përfundimi i themeleve dhe kuota ±0.00m”, ushtrohet vetem pasi të kete përfunduar procedura e konfirmimit të kontrollit të kantierit dhe depozitimit të kontrollit të piketimit sipas përcaktimeve në dy hapat e mësipërm (01, 02).*
*Punimet e ndërtimit për ushtrimin e këtij kontrolli duhet të jenë në fazën e përfundimit të soletës së mbulimit të kuotës ±0.00m.*

# 3/1 HARTIMI I AKT-KONTROLLIT

Ushtrimi dhe hartimi i *Akt-kontrollit* ***"Përfundimi i themeleve dhe kuota ± 0.00m"*** kryhet nga:

**1/ Drejtuesi teknik i subjektit ndërtues**
**2/ Topograf i objektit liçensuar në zbatim ose mbikqyrje**
**3/ Mbikqyrësi i objektit**

Plotësimi i akt kontrollit do të kryhet sipas formatit të ilustruar në faqen pasardhëse miratuar nga Bashkia e Tiranës, i cili mund të gjendet pranë *Sportelit të Pritjes me Qytetarët* pranë Bashkisë së Tiranës ose pranë *SKZL-së.*

**ANEKSI 2-9 / C**

***AKT- KONTROLL***
(Për përfundimin e themeleve dhe kuotës ±0.00)

Mbështetur në ligjin nr. 8402, datë 10/09/1998, për "Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit (i ndryshuar), neni 27/1 VKM nr. 408 datë 13.05.2015 (i ndryshuar), u ushtrua kontroll për përfundimin e kuotës ±0.00m për objektin "........................................", miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë me **nr. ...........** , **datë ...............**, leje ndërtimi me nr.prot. **.........................,** datë **.........................,** me adresë në rrugën **"................................."** në pronë të **..................................,** në favor të zhvilluesit **"..................."** dhe subjektit ndërtues shoqërisë **"......................" *shpk***

Nga kontrolli i ushtruar për kondicionet urbane rezulton se:

1. ***Planvendosja nga veriu:*** Realizuar ballë i (drejtë/shkallëzuar) me gjatësi **......**m në distancë **......**m nga (kufiri i pronës/ mur rrethues/objekt ekzistues), miratuar ballë i (drejtë/shkallëzuar) me gjatësi **......**m në distancë **......**m nga (kufiri i pronës/ mur rrethues/objekt ekzistues).
(.............................................................................................. ..)
2. ***Planvendosja nga lindja:*** Realizuar ballë i (drejtë/shkallëzuar) me gjatësi **......**m në distancë **......**m nga (kufiri i pronës/ mur rrethues/objekt ekzistues), miratuar ballë i (drejtë/shkallëzuar) me gjatësi **......**m në distancë **......**m nga (kufiri i pronës/ mur rrethues/objekt ekzistues).
(.............................................................................................. ..)
3. ***Planvendosja nga perëndimi:*** Realizuar ballë i (drejtë/shkallëzuar) me gjatësi **......**m në distancë **......**m nga (kufiri i pronës/ mur rrethues/objekt ekzistues), miratuar ballë i (drejtë/shkallëzuar) me gjatësi **......**m në distancë **......**m nga (kufiri i pronës/ mur rrethues/objekt ekzistues).
(.............................................................................................. ..)
4. ***Planvendosja nga jugu:*** Realizuar ballë i (drejtë/shkallëzuar) me gjatësi **......**m në distancë **......**m nga (kufiri i pronës/ mur rrethues/objekt ekzistues), miratuar ballë i (drejtë/shkallëzuar) me gjatësi **......**m në distancë **......**m nga (kufiri i pronës/ mur rrethues/objekt ekzistues).
(.............................................................................................. ..)

Nga kontrolli i ushtruar për përfundimin e kuotës ±0.00m të strukturës rezulton se:

1) ***Planimetria e katit ne kuoten -     m:*** Realizuar(sipas/në ndryshim të) projektit të miratuar.
(..............................................................................................)
***Lartësia e katit:*** Realizuar **.......** m (sipas /në ndryshim të ) projektit të miratuar.

2) ***Planimetria e katit përdhe:*** Realizuar(sipas/në ndryshim të) projektit të miratuar.
(..............................................................................................)
**Shenim:** (Për çdo pikë, në rastin kur projekti eshte zbatuar me ndryshime, te detajohet ndryshimi dhe vendodhja sipas akseve)

**INXHINIER TOPOGRAF** ______________________

**DREJTUESI TEKNIK** ______________________

**MBIKËQYRËSI I PUNIMEVE** ______________________

***SHËNIM***

*Formatin e Akt-Kontrollit "Përfundimi i themeleve dhe kuota ± 0.00m"mund ta shkarkoni në faqen zyrtare të Bashkisë së Tiranës:*

*www.tirana.al*

***> Udhëzuesi "Si të aplikosh për konfirmimin e akt-kontrolleve, sipas fazave të ndërtimit"***

*> Aneksi 2-9 / C*

## 3/2 APLIKIMI PËR AKT-KONTROLL

Aplikimi për konfirmimin e *Akt-kontrollit* ***"Përfundimi i themeleve dhe kuota ± 0.00m"***, kryhet pranë *Sportelit të Pritjes me Qytetarët* pranë Bashkisë së Tiranës.

Aplikuesi mund të jetë:
**- Subjekti ndërtues**
**- Zhvilluesi**
**- Çdo person i pajisur me prokurë apo autorizim nga subjekti ndërtues apo zhvillues**

## DOKUMENTET PËR APLIKIM

Dokumentacioni i kërkuar i cili duhet depozituar pranë DPPZHT, përmban:

☐ 1/ **Kërkesë shkresore për depozitim e kontrollit**, me të dhënat identifikuese të objektit sipas lejes së ndërtimit si dhe subjektit që ka ushtruar kontrollin.

☐ 2/ **Akt-kontrolli** i hartuar dhe nenshkruar nga subjekti privat i licensuar. Akti i kontrollit plotesohet sipas Formatit të Aneksit 2-9/C.

☐ 3/ **Deklaratë noteriale përgjegjësie e subjektit** që ka ushtruar dhe hartuar akt-kontrollin. Në deklaratën e përgjegjësise duhet të përfshihet topografi i liçensuar, drejtuesi teknik i subjektit ndërtues dhe mbikqyrësi, të cilët duhet të shprehen mbi vërtetesinë e akt kontrollit të ushtruar prej tyre si dhe zbatimin ose jo të objektit deri në fazën aktuale referuar projektit të miratuar.

**SHËNIM**

*Shih faqen 31.*
*Aneksi 2-9/C*
*Akt Kontrolli "Përfundimi i themeleve dhe kuota ± 0.00m"*



☐ 4/ **Kopje e noterizuar e liçencës së subjektit** që ka ushtruar kontrollin, **nëse është i ndryshëm** nga subjekti që ka ushtruar kontrollet paraardhëse:

☐ • Liçensa e subjektit ndërtues
☐ • Liçensa individuale / shoqerise për punimet topogjeodezike në zbatim ose mbikqyrje
☐ • Liçensa e mbikqyrësit të punimeve

☐ 5/ **Kopje të akt-kontrolleve të mëparshëm:**
01_ Akt - Kontrolli "Ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues"
02_ Akt - Kontrolli "Piketimi i strukturës"

☐ 6/ **Foto të gjendjes faktike** ku pasqyrohet realizimi i punimeve sipas pikave të përcaktuara në akt-kontroll.

**SHËNIM**

*Për lejet e miratuara nga ish-Komunat nëse projekti nuk është depozituar më parë pranë DPPZHT-së, paraprakisht subjektet ose DKZHT i drejtohen Njësive Administrative përkatëse që këto të fundit të dërgojnë kopje të njehsuar të dokumentacionit të lejes së ndërtimit, planvendosjen e miratuar, projektin e miratuar, akt-kontrolle nëse ka etj., pranë DPPZHT.*
*Në çdo rast, sëbashku me dokumentacionin e Njësisë Administrative duhet të depozitohen edhe dokumentat sipas pikave të sipërcituara.*

# 3/2 KONFIRMIMI I AKT-KONTROLLIT




### APLIKIMI PËR KONFIRMIMIN E AKT-KONTROLLIT "PËRFUNDIMI I THEMELEVE DHE KUOTA ± 0.00M"

Aplikimi për konfirmimin e Akt-kontrollit kryhet pranë Sportelit të Pritjes me Qytetarët pranë Bashkisë së Tiranës.

Kërkesa për konfirmimin e akt-kontrollit së bashku me dokumentacionin përkatës delegohet në strukturën përkatëse *"Sektori i Kontrollit të Zbatimit të Lejeve (SKZL)"* nëpërmjet të cilës specialistët inxhinier / arkitekt / topograf vijojnë me verifikimin e objektit.




### VLERËSIMI I APLIKIMIT TË AKT-KONTROLLIT NGA SKZL

Brenda 15 ditë pune, SKZL kthen përgjigje për aplikacionin duke vlerësuar aplikimin në lidhje me dokumentacionin përkatës dhe kontrolluar gjendjen faktike të objektit

#### 2/1 KONFIRMIMI I AKT-KONTROLLIT

Nëse aplikimi për konfirmimin e Akt- kontrollit *"Përfundimi i themeleve dhe kuota ± 0.00m"*, është në rregull me dokumentacionin dhe kontrollin e gjendjes faktike në terren, jepet konfirmimi nga SKZL për të vazhduar me Akt-kontrollin *"Përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin"*.

#### 2/2 NJOFTIM PËR PLOTËSIM / SAKTËSIM DOKUMENTACIONI

- Njoftimi për plotësim dokumentacioni nëse aplikimi ka mungesa apo nevojë për saktësim.
- Plotësimi i dokumentacionit nga aplikuesi.
- Pas plotësimit të dokumentacionit, kontrollohet gjendja faktike e objektit në terren.
- Konfirmimi i akt-kontrollit pas plotësimit të saktë të dokumentacionit.

#### 2/3 KONSTATIM MOSPËRPUTHSHMËRIE

Në rast se konstatohen shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit SKZL njofton IMT.




### VLERËSIMI I AKT - KONTROLLIT NGA IMT

Inspektoriatit Vendor i Mbrojtjes së Territorit merr njoftimin dhe vazhdon me procedurën përkatëse.

# 04 APLIKIMI I AKT - KONTROLLIT **“PËRFUNDIMI I KARABINASË PËR TË GJITHË OBJEKTIN”**

*Akt-kontrolli “Përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin”, ushtrohet vetem pasi të jetë konfirmuar Akt-Kontrolli “Përfundimi i themeleve dhe kuota ± 0.00m”*
*Punimet e ndërtimit për ushtrimin e këtij akt-kontrolli duhet të jenë në fazën kur ka përfunduar skeleti konstruktiv dhe muratura perimetrale për gjithë objektit.*
*Në këtë mënyrë janë konfiguruar dhe janë të kontrollueshme të gjitha planimetritë e kateve të objektit, lartësitë e kateve dhe element të tjerë të përfshirë ne projektin e miratuar.*

# 4/1 HARTIMI I AKT-KONTROLLIT

Ushtrimi dhe hartimi i kontrollit mbi ***"Përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin"*** kryhet nga:

**1/ Drejtuesi teknik i subjektit ndërtues**
**2/ Topograf i objektit liçensuar në zbatim ose mbikqyrje**
**3/ Mbikqyrësi i objektit**

Plotësimi i akt kontrollit do të kryhet sipas formatit të ilustruar në faqen pasardhëse miratuar nga Bashkia e Tiranës, i cili mund të gjendet pranë *Sportelit të Pritjes me Qytetarët* pranë Bashkisë së Tiranës ose pranë *SKZL-së.*



**ANEKSI 2-9 / Ç**

***AKT- KONTROLL***
(Për përfundimin e karabinasë)

Mbështetur në ligjin nr. 8402, datë 10/09/1998, për "Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit (i ndryshuar), neni 27/1 VKM nr. 408 datë 13.05.2015 (i ndryshuar, u ushtrua kontroll për përfundimin e karabinasë për objektin "..................................................", miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë me **nr.** ........... , **datë** ..............., leje ndërtimi me nr.prot. ......................., datë ......................., me adresë në rrugën "................................" në pronë të ................................, në favor të zhvilluesit "..................." dhe subjektit ndërtues shoqërisë "....................." ***shpk***

Nga kontrolli i ushtruar rezulton se:

**Katet nëntokë**

1. **Planimetria e katit në kuotën - m:** Realizuar (sipas/në ndryshim të ) projektit të miratuar. (.......................................................................)
   **Lartësia e katit:** Realizuar ....... m (sipas /në ndryshim të ) projektit të miratuar.
2. **Planimetria e katit në kuotën - m:** Realizuar (sipas/në ndryshim të )projektit të miratuar.
   (.......................................................................)
   **Lartësia e katit:** Realizuar ....... m (sipas /në ndryshim të ) projektit të miratuar.

**Shenim:** (Për çdo pikë, në rastin kur projekti eshte zbatuar me ndryshime, të detajohet ndryshimi dhe vendodhja sipas akseve)

**Katet mbi tokë**

1. **Planimetria e katit në kuotën±0.00m:** Realizuar(sipas/në ndryshim të) projektit të miratuar.
   (.......................................................................)
   **Lartësia e katit:** Realizuar ....... m (sipas /në ndryshim të ) projektit të miratuar.
2. **Planimetria e katit në kuotë n +....m:** Realizuar(sipas/në ndryshim të) projektit të miratuar.
   (.......................................................................)
   **Lartësia e katit:** Realizuar sipas projektit të miratuar.
3. **Planimetria e katit në kuotë n +....m:** Realizuar(sipas/në ndryshim të) projektit të miratuar.
   (.......................................................................)
   **Lartësia e katit:** Realizuar sipas projektit të miratuar.
4. **Plani i tarracës:** Realizuar(sipas/në ndryshim të) projektit të miratuar.
   (.......................................................................)

**Shenim:** (Për çdo pikë, në rastin kur projekti eshte zbatuar me ndryshime, te detajohet ndryshimi dhe vendodhja sipas akseve)

**INXHINIER TOPOGRAF** ____________________

**DREJTUESI TEKNIK** ____________________

**MBIKËQYRËSI I PUNIMEVE** ____________________

**SHËNIM**

*Formatin e Akt-Kontroll "Përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin" mund ta shkarkoni në faqen zyrtare të Bashkisë së Tiranës:*

*www.tirana.al*

***> Udhëzuesi "Si të aplikosh për konfirmimin e akt-kontrolleve, sipas fazave të ndërtimit"***

*> Aneksi 2-9 / Ç*

# 4/2 APLIKIMI I AKT-KONTROLLIT

Aplikimi për konfirmimin e Akt-kontrollit ***"Përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin"***, kryhet pranë *Sportelit të Pritjes me Qytetarët* pranë Bashkisë së Tiranës.

Aplikuesi mund të jetë:
**- Subjekti ndërtues**
**- Zhvilluesi**
**- Çdo person i pajisur me prokurë apo autorizim nga subjekti ndërtues apo zhvillues**

# DOKUMENTET PËR APLIKIM

Dokumentacioni i kërkuar i cili duhet depozituar pranë DPPZHT, përmban:

☐ 1/ **Kërkesë shkresore për depozitim e kontrollit**, me të dhënat identifikuese të objektit sipas lejes së ndërtimit si dhe subjektit që ka ushtruar kontrollin.

☐ 2/ **Akt-kontrolli** i hartuar dhe nenshkruar nga subjekti privat i licensuar. Akti i kontrollit plotesohet sipas Formatit të Aneksit 2-9/Ç.

☐ 3/ **Deklaratë noteriale përgjegjësie e subjektit** që ka ushtruar dhe hartuar akt-kontrollin. Në deklaratën e përgjegjësise duhet të përfshihet topografi i liçensuar, drejtuesi teknik i subjektit ndërtues dhe mbikqyrësi, të cilët duhet të shprehen mbi vërtetesinë e akt kontrollit të ushtruar prej tyre si dhe zbatimin ose jo të objektit deri në fazën aktuale referuar projektit të miratuar.

☐ 4/ **Kopje e noterizuar e liçencës së subjektit** që ka ushtruar kontrollin, **nëse është i ndryshëm** nga subjekti që ka ushtruar kontrollet paraardhëse:

☐ • Liçensa e subjektit ndërtues
☐ • Liçensa individuale / shoqerise për punimet topogjeodezike në zbatim ose mbikqyrje
☐ • Liçensa e mbikqyrësit të punimeve

☐ 5/ **Kopje e aktit të kontrolleve të mëparshëm:**

☐ 01_ Akt - Kontrolli "Ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues"
☐ 02_ Akt - Kontrolli "Piketimi i strukturës"
☐ 03_ Akt - Kontrolli "Përfundimi i themeleve dhe kuota ± 0.00m"

☐ 6/ **Foto të gjendjes faktike** ku pasqyrohet realizimi i punimeve sipas pikave të përcaktuara në akt-kontroll.

*SHËNIM*

*Shih faqen 39.*
*Aneksi 2-9/Ç*
*Akt Kontrolli "Përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin"*

*SHËNIM*

*Për lejet e miratuara nga ish-Komunat nëse projekti nuk është depozituar më parë pranë DPPZHT-së, paraprakisht subjektet ose DKZHT i drejtohen Njësive Administrative përkatëse që këto të fundit të dërgojnë kopje të njehsuar të dokumentacionit të lejes së ndërtimit, planvendosjen e miratuar, projektin e miratuar, akt-kontrolle nëse ka etj., pranë DPPZHT.*
*Në çdo rast, sëbashku me dokumentacionin e Njësisë Administrative duhet të depozitohen edhe dokumentat sipas pikave të sipërcituara.*

# 4/3 KONFIRMIMI NGA DPPZHT




1

## APLIKIMI PËR KONFIRMIMIN E AKT-KONTROLLIT "PËRFUNDIMI I KARABINASË PËR TË GJITHË OBJEKTIN".

Aplikimi për konfirmimin e Akt-kontrollit kryhet pranë Sportelit të Pritjes me Qytetarët pranë Bashkisë së Tiranës.

Kërkesa për konfirmimin e akt-kontrollit së bashku me dokumentacionin përkatës delegohet në strukturën përkatëse *"Sektori i Kontrollit të Zbatimit të Lejeve (SKZL)"* nëpërmjet të cilës specialistët inxhinier / arkitekt / topograf vijojnë me verifikimin e objektit.




2

## VLERËSIMI I APLIKIMIT TË AKT-KONTROLLIT NGA SKZL

Brenda 15 ditë pune, SKZL kthen përgjigje për aplikacionin duke vlerësuar aplikimin në lidhje me dokumentacionin përkatës dhe kontrolluar gjendjen faktike të objektit

### 2/1 KONFIRMIMI I AKT-KONTROLLIT

Nëse aplikimi për konfirmimin e Akt- kontrollit *"Përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin"*, është në rregull me dokumentacionin dhe kontrollin e gjendjes faktike në terren, jepet konfirmimi nga SKZL për të vazhduar me Akt-kontrollin *"Përfundimi i fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re, përfshirë instalimet elektrike, të ngrohjes, ftohjes, hidraulike, të komunikimit elektronik".*

### 2/2 NJOFTIM PËR PLOTËSIM / SAKTËSIM DOKUMENTACIONI

• Njoftimi për plotësim dokumentacioni nëse aplikimi ka mungesa apo nevojë për saktësim.

• Plotësimi i dokumentacionit nga aplikuesi.

• Pas plotësimit të dokumentacionit, kontrollohet gjendja faktike e objektit në terren.

• Konfirmimi i akt-kontrollit pas plotësimit të saktë të dokumentacionit.

### 2/3 KONSTATIM MOSPËRPUTHSHMËRIE

Në rast se konstatohen shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit SKZL njofton IMT.




3

## VLERËSIMI I AKT - KONTROLLIT NGA IMT

Inspektoriatit Vendor i Mbrojtjes së Territorit merr njoftimin dhe vazhdon me procedurën përkatëse.

# 05 APLIKIMI I AKT - KONTROLLIT "PËRFUNDIMI I FASADAVE DHE RIFINITURAVE TË STRUKTURËS SË RE, PËRFSHIRË INSTALIMETELEKTRIKE, TË NGROHJES, FTOHJES, HIDRAULIKE, TË KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK"

*Akt-kontrolli "Përfundimi i fasadave dhe rifiniturave, ushtrohet vetëm pasi të ketë përfunduar procedura e depozitimit dhe konfirmimit të karabinasë". Punimet e ndërtimit për ushtrimin e këtij kontrolli duhet të jenë në fazën kur ka përfunduar të gjitha punimet elektrike, hidraulike, punimet mekanike (ngrohje-ftohje-ventilim), rifiniturat e brendshme dhe të jashtme, fasadat e jashtme. Në këtë mënyrë janë konfiguruar dhe janë të kontrollueshme në raport me projektin e miratuar të gjitha fasadat e objektit, specifikimet teknike e materiale të tyre.*
*Gjithashtu nëpërmjet deklaratave noteriale e realcionet teknike te mbikqyrësve për punimet elektrike hidraulike e mekanike vërtetohet realizimi i tyre sipas projektit, specifikimeve teknike normave e standarteve në fuqi.*

# 5/1 HARTIMI I AKT-KONTROLLIT

Ushtrimi dhe hartimi i kontrollit ***"Përfundimi i fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re, përfshirë instalimetelektrike, të ngrohjes, ftohjes, hidraulike, të komunikimit elektronik"*** kryhet nga:

**1/ Drejtuesi teknik i subjektit ndërtues**
**2/ Mbikqyrësi i objektit**

Plotësimi i akt kontrollit do të kryhet sipas formatit të ilustruar në faqen pasardhëse miratuar nga Bashkia e Tiranës, i cili mund të gjendet pranë *Sportelit të Pritjes me Qytetarët* pranë Bashkisë së Tiranës ose pranë *SKZL-së.*



**ANEKSI 2-9 / D**

***AKT- KONTROLL***
(Për përfundimin e fasadave dhe rifiniturave)

Mbështetur në ligjin nr. 8402, datë 10/09/1998, për "Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit (i ndryshuar), neni 27/1 VKM nr. 408 datë 13.05.2015 (i ndryshuar), u ushtrua kontroll për përfundimin e fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re, përfshirë sistemet e ngrohjes, ftohjes, hidraulike, të komunikimit elektronik për objektin "................................................................................", miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë me **nr.** ............ , **datë** ................, leje ndërtimi me nr.prot. ........................., datë .........................., me adresë në rrugën **"................................."** në pronë të .................................., në favor të zhvilluesit **"..................."** dhe subjektit ndërtues shoqërisë **"....................." *shpk***

Nga kontrolli i ushtruar rezulton se:

1. ***Fasadat dhe rifiniturat:*** : Realizuar (sipas/në ndryshim të ) projektit të miratuar.
   (..........................................................................................................)
2. ***Sistemet e instalimeve të ngrohjes, ftohjes, hidraulike:*** Realizuar (sipas/në ndryshim të ) projektit, mbështetur në deklaratën noteriale (nr..... Rep nr........ Kol., datë ..........) dhe relacionin teknik bashkëngjitur, nga mbikqyrësi i punimeve të ngrohjes, ventilimit dhe hidraulike nga inxhinieri hidro-teknik .................., me license .........., për realizimin e tyre sipas projektit, standarteve dhe normave teknike në fuqi.
   (..........................................................................................................)
3. ***Sistemet e instalimeve elektrike dhe të komunikimit elektronik:*** Realizuar (sipas/ në ndryshim të ) projektit, mbështetur në deklaratën noteriale (nr............. Rep. nr..... Kol. datë ..........) dhe relacionin teknik bashkëngjitur, nga zbatuesi i punimeve ing. ............., për realizimin e tyre sipas projektit, standarteve dhe normave teknike në fuqi.
   (..........................................................................................................)

**Shenim:** (Për çdo pikë, në rastin kur projekti eshte zbatuar me ndryshime, te detajohet ndryshimi dhe vendodhja sipas akseve dhe orientimeve)

| DREJTUES TEKNIK | MBIKËQYRËSI I PUNIMEVE |
| --- | --- |
| ____________________ | ____________________ |

**SHËNIM**

*Formatin e Akt-Kontrollit "Përfundimi i fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re, përfshirë instalimetelektrike, të ngrohjes, ftohjes, hidraulike, të komunikimit elektronik" mund ta shkarkoni në faqen zyrtare të Bashkisë së Tiranës:*

*www.tirana.al*

***> Udhëzuesi "Si të aplikosh për konfirmimin e akt-kontrolleve, sipas fazave të ndërtimit"***

*> Aneksi 2-9 / D*

# 5/2 APLIKIMI I AKT-KONTROLLIT

Aplikimi për konfirmimin e kontrollit ***"Përfundimi i fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re, përfshirë instalimetelektrike, të ngrohjes, ftohjes, hidraulike, të komunikimit elektronik"***, kryhet pranë *Sportelit të Pritjes me Qytetarët* pranë Bashkisë së Tiranës.

Aplikuesi mund të jetë:
**- Subjekti ndërtues**
**- Zhvilluesi**
**- Çdo person i pajisur me prokurë apo autorizim nga subjekti ndërtues apo zhvillues**

# 5/3 DOKUMENTET PËR APLIKIM

Dokumentacioni i kërkuar i cili duhet depozituar pranë DPPZHT, përmban:

☐ 1/ **Kërkesë shkresore për depozitim e kontrollit**, me të dhënat identifikuese të objektit sipas lejes së ndërtimit si dhe subjektit që ka ushtruar kontrollin.

☐ 2/ **Akt-kontrolli** i hartuar dhe nenshkruar nga subjekti privat i licensuar. Akti i kontrollit plotesohet sipas Formatit të Aneksit 2-9/D.

☐ 3/ **Deklaratë noteriale përgjegjësie e subjektit** që ka ushtruar dhe hartuar akt-kontrollin. Në deklaratën e përgjegjësise duhet të përfshihet topografi i liçensuar, drejtuesi teknik i

*Për kontrollin e piketimit të strukturës nuk kryhet konfirmim dhe kontroll nga DKZHT. Kontrolli depozitohet dhe arkivohet në arkivën teknike sëbashku me dokumentacionin shoqërues. Në rastet kur kontrolli i depozituar reflekton gabime ose dokumentacioni nuk është i plotë, DKZHT njofton subjektin ndërtues mbi plotësimet apo korrigjimet përkatëse.*

***SHËNIM***

*Shih faqen 47.*
*Aneksi 2-9 / D*
*Akt Kontrolli "Përfundimi i fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re, përfshirë instalimetelektrike, të ngrohjes, ftohjes, hidraulike, të komunikimit elektronik"*



subjektit ndërtues dhe mbikqyrësi, të cilët duhet të shprehen mbi vërtetesinë e akt kontrollit të ushtruar prej tyre si dhe zbatimin ose jo të objektit deri në fazën aktuale referuar projektit të miratuar.

☐ 4/ **Kopje e noterizuar e liçencës së subjektit** që ka ushtruar kontrollin, **nëse është i ndryshëm** nga subjekti që ka ushtruar kontrollet paraardhëse:

☐ • Liçensa e subjektit ndërtues
☐ • Liçensa individuale / shoqerise për punimet topogjeodezike në zbatim ose mbikqyrje
☐ • Liçensa e mbikqyrësit të punimeve

☐ 5/ **Kopje e aktit të kontrolleve të mëparshëm:**

☐ 01_ Akt - Kontrolli "Ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues"
☐ 02_ Akt - Kontrolli "Piketimi i struktures"
☐ 03_ Akt - Kontrolli "Përfundimi i themeleve dhe kuota ± 0.00m"
☐ 04_ Akt - Kontrolli "Përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin"

☐ 6/ **Relacioni teknik i punimeve hidraulike**, të ngrohjes-ftohjes dhe ventilimit (një kopje origjinale e firmosur në çdo fletë nga mbikqyrësi i punimeve)

☐ 7/ **Licensa profesionale e mbikqyrësit të punimeve hidraulike**, të ngrohjes-ftohjes dhe ventilimit.

☐ 8/ **Deklarata noteriale e përgjegjësisë profesionale** të mbikqyrësit të punimeve hidraulike, të ngrohjes-ftohjes dhe ventilimit.

*SHËNIM*

*Në deklaratën e përgjegjësise duhet të përfshihet drejtuesi teknik i subjektit mbikqyrës, i cili duhet të shprehet mbi vërtetesinë e relacionit teknik te hartuar prej tij si dhe zbatimin ose jo të punimeve sipas projektit, specifikimeve teknike si dhe normave e starndardeve në fuqi.*

☐ 9/ **Relacioni teknik i punimeve të instalimeve elektrike** dhe të komunikimit elektronik (një kopje origjinale e firmosur në çdo fletë nga mbikqyrësi i punimeve)

☐ 10/ **Licensa profesionale e mbikqyrësit të instalimeve elektrike** dhe të komunikimit elektronik (një kopje e noteruar)

☐ 11/ **Deklarata noteriale e përgjegjësisë profesionale** të mbikqyrësit të nimeve hidraulike, të ngrohjes-ftohjes dhe ventilimit.

☐ 12/ **Foto të gjendjes faktike** ku pasqyrohet realizimi i punimeve sipas pikave të përcaktuara në akt-kontroll.

*SHËNIM*

*Për lejet e miratuara nga ish-Komunat nëse projekti nuk është depozituar më parë pranë DPPZHT-së, paraprakisht subjektet ose DKZHT i drejtohen Njësive Administrative përkatëse që këto të fundit të dërgojnë kopje të njehsuar të dokumentacionit të lejes së ndërtimit, planvendosjen e miratuar, projektin e miratuar, akt-kontrolle nëse ka etj. pranë DPPZHT.*
*Në çdo rast, sëbashku me dokumentacionin e Njësisë Administrative duhet të depozitohen edhe dokumentat sipas pikave të sipërcituara.*



## 5/3 KONFIRMIMI NGA DPPZHT

Për kontrollin e përfundimin e fasadave dhe rifiniturave **nuk kryhet konfirmim** dhe kontroll nga DKZHT.

Kontrolli depozitohet dhe arkivohet në arkivën teknike sëbashku me dokumentacionin shoqërues. Në rastet kur kontrolli i depozituar reflekton gabime ose dokumentacioni nuk është i plotë, DKZHT njofton subjektin ndërtues mbi plotësimet apo korrigjimet përkatëse.

06

# APLIKIMI I AKT - KONTROLLIT

## “PËRFUNDIMI I SISTEMIMIT TË JASHTËM, NË PLANIN E VENDOSJES SË STRUKTURËS SË RE, PËRFSHIRË VENDOSJEN E KUTISË POSTARE DHE LIDHJEN ME INFRASTRUKTURAT PUBLIKE”

*Akt-Kontrolli “Përfundimi i sistemimit të jashtëm, në planin e vendosjes së strukturës së re, përfshirë vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturat publike ekzistuese” ushtrohet vetem pasi të kete përfunduar procedura e depozitimit të kontrollit të përfundimit të fasadave dhe rifiniturave. Punimet e ndërtimit për ushtrimin e këtij akt-kontrolli duhet të jenë në fazën kur kanë përfunduar të gjitha punimet e ndërtimit në objekt përfshirë dhe sistemimet e brendshme e të jashtme sipas planimetrisë së sistemimeve të miratuar, të jetë kryer lidhja e gjithe infrastrukturës së nevojshme dhe e përcaktuar në akt kontroll si dhe të jetë kryer heqja e rrethimit të përkohshem së kantierit.*
*Duke qënë se kontrolli i sistemimeve është kontrolli final, objekti duhet të jetë gati për shfrytëzim.*

# 6/1 HARTIMI I AKT-KONTROLLIT

Ushtrimi dhe hartimi i *Akt-kontrollit* ***“Përfundimi i sistemimit të jashtëm, në planin e vendosjes së strukturës së re, përfshirë vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturat publike ekzistuese”*** kryhet nga:

**1/ Drejtuesi teknik i subjektit ndërtues**

**2/ Mbikqyrësi i objektit**

Plotësimi i akt kontrollit do të kryhet sipas formatit të ilustruar në faqen pasardhëse miratuar nga Bashkia e Tiranës, i cili mund të gjendet pranë *Sportelit të Pritjes me Qytetarët* pranë Bashkisë së Tiranës ose pranë *SKZL-së.*



**ANEKSI 2-9 / DH**

***AKT- KONTROLL***

*(Për përfundimin e sistemimit të jashtme)*

Mbështetur në ligjin nr. 8402, datë 10/09/1998, për “Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit (i ndryshuar), neni 27/1 VKM nr. 408 datë 13.05.2015 (i ndryshuar), u ushtrua kontroll për përfundimin e sistemimit të jashtëm, përfshirë vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturat publike ekzistuese për objektin “ ..............................................................................”, miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë me **nr.** ............ , **datë** ................, leje ndërtimi me nr.prot. ..........................., datë ..........................., me adresë në rrugën “.....................................” në pronë të ................................................., në favor të zhvilluesit “ ...........................” dhe subjektit ndërtues shoqërisë “.......................” ***shpk***

Nga kontrolli i ushtruar rezulton se:

- ***Sistemimet brenda pronës:***

1. ***Kati nëntokë:*** Realizuar me destinacionin ......................., (sipas/në ndryshim të ) projektit të miratuar.
2. ***Rrugët:*** (Janë/ Nuk janë)realizuar.
3. ***Trotuarët:*** (Janë/ Nuk janë)realizuar.
4. ***Pemë dhe gjelbërim:*** (Janë/ Nuk janë) realizuar.
5. ***Kutia postare:*** (Është/nuk është) Realizuar.
6. ***Lidhja me infrastrukturat publike ekzistuese:*** Realizuar (sipas/në ndryshim të ) projektit të miratuar, mbështetur në Akt-Kolaudimin me nr.prot. ____, datë ____________, për rrjetin inxhinierik të ujsjellës-kanalizime, si dhe Proces Verbalin me nr.prot. ____, datë ________, për furnizimin me energji elektrike.

- ***Sistemimet e ambjentit jashtë pronës të dëmtuar nga ndërtimi.***

1. ***Largimi i çdo mbeturine ndërtimore të shkaktuar nga firma edhe jashtë sheshit të ndërtimit:*** (Është realizuar/ Nuk është realizuar).
2. ***Rrugët kryesore dhe trotuarët e tyre:***

**DREJTUES TEKNIK** ______________________

**MBIKËQYRËSI I PUNIMEVE** ______________________

**SHËNIM**

*Formatin e Akt-Kontrollit “Përfundimi i sistemimit të jashtëm, në planin e vendosjes së strukturës së re, përfshirë vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturat publike ekzistuese” mund ta shkarkoni në faqen zyrtare të Bashkisë së Tiranës:*

*www.tirana.al*

***> Udhëzuesi “Si të aplikosh për konfirmimin e akt-kontrolleve, sipas fazave të ndërtimit”***

*> Aneksi 2-9 / DH*

# 6/2 APLIKIMI I AKT-KONTROLLIT

Aplikimi për konfirmimin e kontrollit ***"Përfundimi i sistemimit të jashtëm, në planin e vendosjes së strukturës së re, përfshirë vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturat publike ekzistuese"***, kryhet pranë *Sportelit të Pritjes me Qytetarët* pranë Bashkisë së Tiranës.

Aplikuesi mund të jetë:
**- Subjekti ndërtues**
**- Zhvilluesi**

# DOKUMENTET PËR APLIKIM

Dokumentacioni i kërkuar i cili duhet depozituar pranë DPPZHT, përmban:

☐ 1/ **Kërkesë shkresore sqaruese për ushtrimin e kontrollit**, me të dhënat identifikuese të objektit sipas lejes së ndërtimit si dhe subjektit që ka ushtruar akt-kontrollin.

☐ 2/ **Akt-kontrolli** i hartuar dhe nenshkruar nga subjekti privat i licensuar. Akti i kontrollit plotesohet sipas Formatit të Aneksit 2-9/DH.

☐ 3/ **Deklaratë noteriale përgjegjësie e subjektit** që ka ushtruar dhe hartuar akt-kontrollin. Në deklaratën e përgjegjësise duhet të përfshihet topografi i liçensuar, drejtuesi teknik i subjektit ndërtues dhe mbikqyrësi, të cilët duhet të shprehen mbi vërtetesinë e akt kontrollit të ushtruar prej tyre si dhe zbatimin ose jo të objektit deri në fazën aktuale referuar projektit të miratuar.

**SHËNIM**

*Shih faqen 55.*
*Aneksi 2-9/DH*
*Akt Kontrolli "Përfundimi i sistemimit të jashtëm, në planin e vendosjes së strukturës së re, përfshirë vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturat publike ekzistuese"*

☐ 4/ **Kopje e noterizuar e liçencës së subjektit** që ka ushtruar kontrollin, nëse është i ndryshëm nga subjekti që ka ushtruar kontrollet paraardhëse:

☐ • Liçensa e subjektit ndërtues
☐ • Liçensa individuale / shoqerise për punimet topogjeodezike në zbatim ose mbikqyrje
☐ • Liçensa e mbikqyrësit të punimeve

☐ 5/ **Kopje e akteve të kontrolleve të mëparshëm:**

☐ 01_ Akt - Kontrolli "Ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues"
☐ 02_ Akt - Kontrolli "Piketimi i struktures"
☐ 03_ Akt - Kontrolli "Përfundimi i themeleve dhe kuota ± 0.00m"
☐ 04_ Akt - Kontrolli "Përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin"
☐ 05_ Akt - Kontrolli "Përfundimi i fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re, përfshirë instalimet elektrike, të ngrohjes, ftohjes, hidraulike, të komunikimit elektronik"

☐ 6/ **Foto të gjendjes faktike** ku pasqyrohet realizimi i punimeve sipas pikave të përcaktuara në akt-kontroll.

**SHËNIM**

*Për lejet e miratuara nga ish-Komunat nëse projekti nuk është depozituar më parë pranë D.P.P.ZH.T-së, paraprakisht subjektet ose D.K.ZH.T i drejtohen Njësive Administrative përkatëse që këto të fundit të dërgojnë kopje të njehsuar të dokumentacionit të lejes së ndërtimit, planvendosjen e miratuar, projektin e miratuar, akt-kontrolle nëse ka etj. pranë DPPZHT.*
*Në çdo rast, sëbashku me dokumentacionin e Njësisë Administrative duhet të depozitohen edhe dokumentat sipas pikave të sipërcituara.*

## 7/ Akt-kolaudim i rrjetit inxhinierik nga UKT-sha.

Ky dokument është i detyrueshem për konfirmimin e kontrollit pasi vërteton zbatimin ose jo të lidhjes së rrjetit të ujësjellësit dhe rrjetit të kanalizimeve sipas projektit të miratuar nga UKT-sha.

Referohuni rastit ilustrues:



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri
Tel: 08004488
info@ukt.al
NIPT L72320033P

**MIRATOI**

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**AKT – KOLAUDIMI**

**I RRJETIT INXHINIERIK TË UJËSJELLËS – KANALIZIMEVE**

Subjekti ndërtues " " **sh.p.k.** me shkresë Nr. prot, më datë , ka paraqitur pranë U.K.T sh.a dokumentacionin mbi kërkesën për akt-kolaudim të objektit: *"Kompleks banimi dhe shërbime 2 dhe 7 kate me 1 kat parkim nëntokë"*, në pronë të shoqërisë , me leje Vendim të K.RR.T.-së Nr. datë të Bashkisë Tiranë, me adresë: rruga " "

**Komisioni i ngritur për verifikimin e punimeve vlerësoi si më poshtë :**

**RRJETI I UJËSJELLËSIT:**

- Subjekti ndërtues **sh.p.k.** ka kryer zbatimin e punimeve të furnizimit me ujë **sipas projektit të hartuar e miratuar nga UKT sh.a.**
- Cilësia e punimeve të zbatimit është _____
- Është vendosur matësi i bilancit sipas projektit *Φ 2" , shasi 17050658*
- Në objekt janë vendosur matësa uji për familjarë *232 (dyqind e tridhjetë e dy)*
- Në objekt janë vendosur matësa uji për dyqane *32 ( tridhjetë e dy)*
- Objekti ka bërë lidhje kontrate për familjarë *232 (dyqind e tridhjetë e dy)*
- Objekti ka bërë lidhje kontrate për dyqane *32 ( tridhjetë e dy)*
- Objekte me destinacione të tjera _____

**RRJETI I KANALIZIMIT:**

- Subjekti ndërtues **sh.p.k.** ka kryer zbatimin e punimeve të shkarkimit të rrjetit K.U.Z sipas projektit **të hartuar e miratuar nga UKT sh.a.**
- Cilësia e punimeve të zbatimit është:____.

Bazuar në të dhënat e mësipërme: **UKT sh.a. merr në shfrytëzim rrjetin e Ujësjellës-Kanalizimeve të objektit të ndërtuar nga subjekti: sh.p.k..**

**Akt- Kolaudimi mbahet në 6 kopje, nga të cilat 3 kopje i bashkalidhen dokumentacionit teknik i arkivës së degëve përkatëse, 2 kopje dorëzohen në Urbanistikë pranë Bashkisë, 1 kopje për subjektin ndërtues.**

**Drejtor i Departamentit Inxhinierik**

**Drejtor i Departamentit të Shitjes**
**Elvin TIVARI**

Ujësjellës Kanalizime sh.a. Tiranë NIPT L72320033P Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri
Tel 08004488, info@ukt.al.



## 8/ Procesverbal i furnizimit me energji elektrike nga OSHEE.

Ky dokument është i detyrueshem për konfirmimin e kontrollit pasi vërteton zbatimin ose jo të lidhjes së objektit me energji elektrike nga OSSHE.

Referohuni rastit ilustrues:



OSHEE OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

Nr. Tiranë, me.

Lënda: **Proces – Verbal i furnizimit me energji elektrike**

Drejtuar: **Shoqerise shpk**

Ne lidhje me proçeduren e furnizimit me energji elektrike te objektit te ndertuar nga shoqeria '' " shpk sqarojme se:
Ne baze te Leje Zhvillimore Ndertimi Nr. Prot./ date 10/10/2014 Miratuar me Vendim te Kryetarit te Bashkise Nr. date 20/08/2014 shoqerise " " shpk i eshte miratuar Leje Zhvillimore Ndertimi per Struksturen ''Kompleks Banimi dhe Sherbime 2 dhe 7 kate me 1 kat parkim nentoke'' me adrese '' '' Tirane eshte lidhur me energji elektrike duke plotesuar te gjithe dokumentacionin dhe kushtet teknike per venien ne shfrytezim te objektit.

Duke ju ururar punë të mbarë,

Me respekt,

**OSHEE sh.a.**

A: Bulevardi "Gjergj Fishta",Ndërtesa Nr. 88, H.1, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tirana, AlbaniaNIPT: K72410014H

# 6/3 KONFIRMIMI NGA DPPZHT




### APLIKIMI PËR KONFIRMIMIN E AKT-KONTROLLIT “PËRFUNDIMI I SISTEMIMIT TË JASHTËM, NË PLANIN E VENDOSJES SË STRUKTURËS SË RE, PËRFSHIRË VENDOSJEN E KUTISË POSTARE DHE LIDHJEN ME INFRASTRUKTURAT PUBLIKE EKZISTUESE”

Aplikimi për konfirmimin e Akt-kontrollit kryhet pranë Sportelit të Pritjes me Qytetarët pranë Bashkisë së Tiranës.

Kërkesa për konfirmimin e akt-kontrollit së bashku me dokumentacionin përkatës delegohet në strukturën përkatëse *“Sektori i Kontrollit të Zbatimit të Lejeve (SKZL)”* nëpërmjet të cilës specialistët inxhinier / arkitekt / topograf vijojnë me verifikimin e objektit.




### VLERËSIMI I APLIKIMIT TË AKT-KONTROLLIT NGA SKZL

Brenda 15 ditë pune, SKZL kthen përgjigje për aplikacionin duke vlerësuar aplikimin në lidhje me dokumentacionin përkatës dhe kontrolluar gjendjen faktike të objektit

#### 2/1 KONFIRMIMI I AKT-KONTROLLIT

Nëse aplikimi për konfirmimin e Akt- kontrollit *“Përfundimi i sistemimit të jashtëm, në planin e vendosjes së strukturës së re, përfshirë vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturat publike ekzistuese”*, është në rregull me dokumentacionin dhe kontrollin e gjendjes faktike në terren, jepet konfirmimi nga SKZL për të vazhduar me pas me aplikimin për çertifikatë përdorimi.

#### 2/2 NJOFTIM PËR PLOTËSIM / SAKTËSIM DOKUMENTACIONI

• Njoftimi për plotësim dokumentacioni nëse aplikimi ka mungesa apo nevojë për saktësim.

• Plotësimi i dokumentacionit nga aplikuesi.

• Pas plotësimit të dokumentacionit, kontrollohet gjendja faktike e objektit në terren.

• Konfirmimi i akt-kontrollit pas plotësimit të saktë të dokumentacionit.

#### 2/3 KONSTATIM MOSPËRPUTHSHMËRIE

Në rast se konstatohen shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit SKZL njofton IMT.




### VLERËSIMI I AKT - KONTROLLIT NGA IMT

Inspektoriatit Vendor i Mbrojtjes së Territorit merr njoftimin dhe vazhdon me procedurën përkatëse.

# SHQYRTIMI I AKT-KONTROLLEVE AFATET KOHORE

# KOHËZGJATJA E PROCESIT:

Procesi kalon në këto hapa:

## 1

**KONFIRMIMI I AKT-KONTROLLIT "NGRITJA E KANTIERIT TË PUNIMEVE, PËRFSHIRË MURIN RRETHUES"**

**AFATI 15 DITË PUNE**

**1/APLIKIMI PËR KONFIRMIMIN E AKT-KONTROLLIT "NGRITJA E KANTIERIT TË PUNIMEVE, PËRFSHIRË MURIN RRETHUES"**

Aplikimi për konfirmimin e Akt-kontrollit kryhet pranë Sportelit të Pritjes me Qytetarët pranë Bashkisë së Tiranës.

Kërkesa për konfirmimin e akt-kontrollit së bashku me dokumentacionin përkatës delegohet në strukturën përkatëse *"Sektori i Kontrollit të Zbatimit të Lejeve (SKZL)"*, nëpërmjet të cilës specialistët inxhinier / arkitekt / topograf vijojnë me verifikimin e objektit.

**2/ VLERËSIMI I APLIKIMIT TË AKT-KONTROLLIT NGA SKZL**

SKZL kthen përgjigje për aplikacionin duke vlerësuar aplikimin në lidhje me dokumentacionin përkatës dhe kontrolluar gjendjen faktike të objektit:

**2/1 KONFIRMIMI I AKT-KONTROLLIT**
Nëse aplikimi për konfirmimin e Akt- kontrollit *"Ngritja e Kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues",* është në rregull me dokumentacionin dhe kontrollin e gjendjes faktike në terren, jepet konfirmimi nga SKZL për të vazhduar me Akt-kontrollin *"Piketimi i struktures"*.

**2/2 NJOFTIM PËR PLOTËSIM / SAKTËSIM DOKUMENTACIONI**
- Njoftimi për plotësim dokumentacioni nëse aplikimi ka mungesa apo nevojë për saktësim.
- Plotësimi i dokumentacionit nga aplikuesi.
- Pas plotësimit të dokumentacionit, kontrollohet gjendja faktike e objektit në terren.
- Konfirmimi i akt-kontrollit pas plotësimit të saktë të dokumentacionit.

**2/3 KONSTATIM MOSPËRPUTHSHMËRIE**
Në rast se konstatohen shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit SKZL njofton IMT.

**3/ VLERËSIMI I AKT - KONTROLLIT NGA IMT**
Inspektoriatit Vendor i Mbrojtjes së Territorit merr njoftimin dhe vazhdon me procedurën përkatëse.

## 2

**KONFIRMIMI I AKT-KONTROLLIT "PIKETIMI I STRUKTURËS"**

**AFATI 15 DITË PUNE**

**1/APLIKIMI PËR KONFIRMIMIN E AKT-KONTROLLIT "PIKETIMI I STRUKTURËS"**

Aplikimi për konfirmimin e Akt-kontrollit kryhet pranë Sportelit të Pritjes me Qytetarët pranë Bashkisë së Tiranës.

Kërkesa për konfirmimin e akt-kontrollit së bashku me dokumentacionin përkatës delegohet në strukturën përkatëse *"Sektori i Kontrollit të Zbatimit të Lejeve (SKZL)"*, nëpërmjet të cilës specialistët inxhinier / arkitekt / topograf vijojnë me verifikimin e objektit.

SHËNIM:

*Për Akt-kontrollin* ***"Piketimi i strukturës"*** *nuk kryhet konfirmim dhe kontroll nga DKZHT.*
*Kontrolli depozitohet dhe arkivohet në arkivën teknike së bashku me dokumentacionin shoqërues.*

*Në rastet kur kontrolli i depozituar reflekton gabime ose dokumentacioni nuk është i plotë,*
*DKZHT njofton subjektin ndërtues mbi plotësimet apo korrigjimet përkatëse.*

## 3

**KONFIRMIMI I AKT-KONTROLLIT "PËRFUNDIMI I THEMELEVE DHE KUOTA ± 0.00M"**

**AFATI 15 DITË PUNE**

**1/APLIKIMI PËR KONFIRMIMIN E AKT-KONTROLLIT "PËRFUNDIMI I THEMELEVE DHE KUOTA ± 0.00M"**

Aplikimi për konfirmimin e Akt-kontrollit kryhet pranë Sportelit të Pritjes me Qytetarët pranë Bashkisë së Tiranës.

Kërkesa për konfirmimin e akt-kontrollit së bashku me dokumentacionin përkatës delegohet në strukturën përkatëse *"Sektori i Kontrollit të Zbatimit të Lejeve (SKZL)"* nëpërmjet të cilës specialistët inxhinier / arkitekt / topograf vijojnë me verifikimin e objektit.

**2/ VLERËSIMI I APLIKIMIT TË AKT-KONTROLLIT NGA SKZL**

SKZL kthen përgjigje për aplikacionin duke vlerësuar aplikimin në lidhje me dokumentacionin përkatës dhe kontrolluar gjendjen faktike të objektit:

**2/1 KONFIRMIMI I AKT-KONTROLLIT**
Nëse aplikimi për konfirmimin e Akt- kontrollit *"Përfundimi i themeleve dhe kuota ± 0.00m",* është në rregull me dokumentacionin dhe kontrollin e gjendjes faktike në terren, jepet konfirmimi nga SKZL për të vazhduar me Akt-kontrollin *"Përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin".*

**2/2 NJOFTIM PËR PLOTËSIM / SAKTËSIM DOKUMENTACIONI**
- Njoftimi për plotësim dokumentacioni nëse aplikimi ka mungesa apo nevojë për saktësim.
- Plotësimi i dokumentacionit nga aplikuesi.
- Pas plotësimit të dokumentacionit, kontrollohet gjendja faktike e objektit në terren.
- Konfirmimi i akt-kontrollit pas plotësimit të saktë të dokumentacionit.

**2/3 KONSTATIM MOSPËRPUTHSHMËRIE**
Në rast se konstatohen shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit SKZL njofton IMT.

**3/ VLERËSIMI I AKT - KONTROLLIT NGA IMT**
Inspektoriatit Vendor i Mbrojtjes së Territorit merr njoftimin dhe vazhdon me procedurën përkatëse.



## 4

**KONFIRMIMI I AKT-KONTROLLIT "PËRFUNDIMI I KARABINASË PËR TË GJITHË OBJEKTIN"**

**AFATI 15 DITË PUNE**

**1/APLIKIMI PËR KONFIRMIMIN E AKT-KONTROLLIT "PËRFUNDIMI I KARABINASË PËR TË GJITHË OBJEKTIN".**

Aplikimi për konfirmimin e Akt-kontrollit kryhet pranë Sportelit të Pritjes me Qytetarët pranë Bashkisë së Tiranës.

Kërkesa për konfirmimin e akt-kontrollit së bashku me dokumentacionin përkatës delegohet në strukturën përkatëse *"Sektori i Kontrollit të Zbatimit të Lejeve (SKZL)"* nëpërmjet të cilës specialistët inxhinier / arkitekt / topograf vijojnë me verifikimin e objektit.

**2/ VLERËSIMI I APLIKIMIT TË AKT-KONTROLLIT NGA SKZL**

SKZL kthen përgjigje për aplikacionin duke vlerësuar aplikimin në lidhje me dokumentacionin përkatës dhe kontrolluar gjendjen faktike të objektit:

**2/1 KONFIRMIMI I AKT-KONTROLLIT**
Nëse aplikimi për konfirmimin e Akt- kontrollit *"Përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin",* është në rregull me dokumentacionin dhe kontrollin e gjendjes faktike në terren, jepet konfirmimi nga SKZL për të vazhduar me Akt-kontrollin *"Përfundimi i fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re, përfshirë instalimet elektrike, të ngrohjes, ftohjes, hidraulike, të komunikimit elektronik".*

**2/2 NJOFTIM PËR PLOTËSIM / SAKTËSIM DOKUMENTACIONI**
- Njoftimi për plotësim dokumentacioni nëse aplikimi ka mungesa apo nevojë për saktësim.
- Plotësimi i dokumentacionit nga aplikuesi.
- Pas plotësimit të dokumentacionit, kontrollohet gjendja faktike e objektit në terren.
- Konfirmimi i akt-kontrollit pas plotësimit të saktë të dokumentacionit.

**2/3 KONSTATIM MOSPËRPUTHSHMËRIE**
Në rast se konstatohen shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit SKZL njofton IMT.

**3/ VLERËSIMI I AKT - KONTROLLIT NGA IMT**
Inspektoriatit Vendor i Mbrojtjes së Territorit merr njoftimin dhe vazhdon me procedurën përkatëse.

## 5

**KONFIRMIMI I AKT-KONTROLLIT "PËRFUNDIMI I FASADAVE DHE RIFINITURAVE TË STRUKTURËS SË RE, PËRFSHIRË INSTALIMET ELEKTRIKE, TË NGROHJES, FTOHJES, HIDRAULIKE, TË KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK"**

**AFATI 15 DITË PUNE**

**1/APLIKIMI PËR KONFIRMIMIN E AKT-KONTROLLIT "PËRFUNDIMI I FASADAVE DHE RIFINITURAVE TË STRUKTURËS SË RE, PËRFSHIRË INSTALIMET ELEKTRIKE, TË NGROHJES, FTOHJES, HIDRAULIKE, TË KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK"**

Aplikimi për konfirmimin e Akt-kontrollit kryhet pranë Sportelit të Pritjes me Qytetarët pranë Bashkisë së Tiranës.

Kërkesa për konfirmimin e akt-kontrollit së bashku me dokumentacionin përkatës delegohet në strukturën përkatëse *"Sektori i Kontrollit të Zbatimit të Lejeve (SKZL)"*, nëpërmjet të cilës specialistët inxhinier / arkitekt / topograf vijojnë me verifikimin e objektit.

SHËNIM:

*Për Akt-kontrollin* **"Përfundimi i fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re, përfshirë instalimetelektrike, të ngrohjes, ftohjes, hidraulike, të komunikimit elektronik"** *nuk kryhet konfirmim dhe kontroll nga DKZHT.*
*Kontrolli depozitohet dhe arkivohet në arkivën teknike së bashku me dokumentacionin shoqërues.*

*Në rastet kur kontrolli i depozituar reflekton gabime ose dokumentacioni nuk është i plotë, DKZHT njofton subjektin ndërtues mbi plotësimet apo korrigjimet përkatëse.*

## 6

**KONFIRMIMI I AKT-KONTROLLIT "PËRFUNDIMI I SISTEMIMIT TË JASHTËM, NË PLANIN E VENDOSJES SË STRUKTURËS SË RE, PËRFSHIRË VENDOSJEN E KUTISË POSTARE DHE LIDHJEN ME INFRASTRUKTURAT PUBLIKE EKZISTUESE"**

**AFATI 15 DITË PUNE**

**1/APLIKIMI PËR KONFIRMIMIN E AKT-KONTROLLIT "PËRFUNDIMI I SISTEMIMIT TË JASHTËM, NË PLANIN E VENDOSJES SË STRUKTURËS SË RE, PËRFSHIRË VENDOSJEN E KUTISË POSTARE DHE LIDHJEN ME INFRASTRUKTURAT PUBLIKE EKZISTUESE"**

Aplikimi për konfirmimin e Akt-kontrollit kryhet pranë Sportelit të Pritjes me Qytetarët pranë Bashkisë së Tiranës.

Kërkesa për konfirmimin e akt-kontrollit së bashku me dokumentacionin përkatës delegohet në strukturën përkatëse *"Sektori i Kontrollit të Zbatimit të Lejeve (SKZL)"* nëpërmjet të cilës specialistët inxhinier / arkitekt / topograf vijojnë me verifikimin e objektit.

**2/ VLERËSIMI I APLIKIMIT TË AKT-KONTROLLIT NGA SKZL**

SKZL kthen përgjigje për aplikacionin duke vlerësuar aplikimin në lidhje me dokumentacionin përkatës dhe kontrolluar gjendjen faktike të objektit:

**2/1 KONFIRMIMI I AKT-KONTROLLIT**
Nëse aplikimi për konfirmimin e Akt- kontrollit *"Përfundimi i sistemimit të jashtëm, në planin e vendosjes së strukturës së re, përfshirë vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturat publike ekzistuese"*, është në rregull me dokumentacionin dhe kontrollin e gjendjes faktike në terren, jepet konfirmimi nga SKZL për të vazhduar me pas me aplikimin për çertifikatë përdorimi.

**2/2 NJOFTIM PËR PLOTËSIM / SAKTËSIM DOKUMENTACIONI**
- Njoftimi për plotësim dokumentacioni nëse aplikimi ka mungesa apo nevojë për saktësim.
- Plotësimi i dokumentacionit nga aplikuesi.
- Pas plotësimit të dokumentacionit, kontrollohet gjendja faktike e objektit në terren.
- Konfirmimi i akt-kontrollit pas plotësimit të saktë të dokumentacionit.

**2/3 KONSTATIM MOSPËRPUTHSHMËRIE**
Në rast se konstatohen shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit SKZL njofton IMT.

**3/ VLERËSIMI I AKT - KONTROLLIT NGA IMT**
Inspektoriatit Vendor i Mbrojtjes së Territorit merr njoftimin dhe vazhdon me procedurën përkatëse.

# PËRMBLEDHJE E PROCESIT

## PËRMBLEDHJA E PROCESIT:

*SHENIM !*

*Në mënyrë që procesi të jetë sa më i qartë dhe të qartësohet se në cilën fazë aplikohet për konfirmimin e akt-kontrolleve sipas fazave të ndërtimit, është paraqitur e gjithë skema që në momentin e pajisjes me leje ndërtimi, e deri tek regjistrimi i objektit në ZVRPP.*

***Ky udhëzues, detajon vetëm mënyrën e aplikimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për konfirmim e akt-ontrolleve sipas fazave të ndërtimit.***




### PAJISJA ME LEJE NDËRTIMI

**Pas miratimit të lejes së ndërtimit** dhe fillimin e punimeve, subjektet ndërtuese nëpërmjet subjekteve të liçensuar në fushën e mbikqyrjes, kanë detyrimin që për çdo fazë ndërtimi, hap pas hapi, të hartojnë akt-kontrollet teknike të fazave të ndërtimit dhe të njoftojnë Bashkinë e Tiranës / DPPZHT, për kontrollin dhe verifikimin e realizimit të tyre.

*SHËNIM*

Për dokumentacionin e nevojshëm dhe mënyrën e aplikimit për pajisjen me leje ndërtimi, referojuni *Udhëzuesit "Si të aplikosh për leje ndërtimi".*




### KONFIRMIMI I AKT-KONTROLLEVE SIPAS FAZAVE TË NDËRTIMIT

01_ Akt - Kontrolli **"Ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues"**

02_ Akt - Kontrolli **"Piketimi i strukturës"**

03_ Akt - Kontrolli **"Përfundimi i themeleve dhe kuota ± 0.00m"**

04_ Akt - Kontrolli **"Përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin"**

05_ Akt - Kontrolli **"Përfundimi i fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re, përfshirë instalimet elektrike, të ngrohjes, ftohjes, hidraulike, të komunikimit elektronik"**

06_ Akt - Kontrolli **"Përfundimi i sistemimit të jashtëm, në planin e vendosjes së strukturës së re,përfshirë vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturat publike ekzistuese"**




### PAJISJA ME ÇERTIFIKATË PËRDORIMI TË OBJEKTIT

Pasi objekti është pajisur me të gjitha akt kontrollet sipas fazave të ndërtimit dhe aktet e kontrollit vërtetojnë realizimin e objektit sipas projektit të miratuar, subjektet ndërtuese mund të vijojnë me aplikimin për Çertifikatë Përdorimi nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve.

Për dokumentacionin e nevojshëm dhe mënyrën e aplikimit për pajisjen me Çertifikatë përdorimi, referojuni *Udhëzuesit "Si të aplikosh për Çertifikatë përdorimi".*




### REGJISTRIMI I OBJEKTIT NË ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

Pasi ka përfunduar gjithë procesi dhe janë konfirmuar të gjitha hapat e mëparshëm, objekti mund të regjistrohet pranë ZVRPP dhe ka të drejta të plota përdorimi të objektit.

**REFERENCA LIGJORE DHE ADMINISTRATIVE:**

*- Ligji 107/2014 dt. 31/07/2014 (i ndryshuar) "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*
*- VKM 408 dt. 13/05/2015 (i ndryshuar) "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit"*
*- Ligji 8402 datë dt. 10/09/1998 (i ndryshuar) "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*
*- Urdhëresa e Kryetarit të Bashkisë Tiranë me nr. 43743 dt. 04.12.2017 "Për procedurën e shqyrtimit të aplikimeve për leje zhvillimi/ndërtimi, deklaratë paraprake për kryerje punimesh, çertifikatë përdorimi, genplane azhornimi, rishikim i kushteve të lejes, shtyrje afati të lejes së ndërtimit, ndryshim i aktiviteteve / funksioneve dhe përditësimet e infrastrukturave të tjera nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve".*

Udhëzuesi ***“Si të aplikosh për Konfirmimin e Akt-Kontrolleve sipas Fazave të Ndërtimit”***,
është pjesë e një pakete informative për zbatimin e bazës tekniko - ligjore sipas kushteve të zhvillimit të përcaktuara në legjislacionin dhe rregulloret përkatëse në fuqi, së bashku me:

*Udhëzuesin “Si të aplikosh për Leje Zhvillimi”*
*Udhëzuesin “Si të aplikosh për konfirmim e Akt-kontrolleve”*
*Udhëzuesin “Si të aplikosh për çertifikatë përdorimi”*
*Udhëzuesin “Si të aplikosh për Plan të Detajuar Vendor”*
*Udhëzuesin “Si të aplikosh për Deklaratë Paraprake për Kryerje Punimesh”*
*Udhëzuesin “Si të aplikosh për Gen-plan Azhornimi”*

Përgatitur nga Bashkia e Tiranës me mbështetje teknike të Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Sheshi “Skënderbej”,
Nd. 2, Kodi postar 1001,
Tiranë, Shqipëri

www.tirana.al